



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 15 shtator 2023
Nr. ref.:RK 2253/23

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI57/23

Parashtrues

Ismet Ferati

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [Ac.nr.9423/21], të 6 dhjetorit
2022, të Gjykatës së Apelit të Kosovës**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar,
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar dhe
Enver Peci, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Ismet Ferati (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës), me vendbanim në Komunën e Vushtrrisë, i përfaqësuar nga Nysret Mjeku, avokat.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin [Ac.nr.9423/21], të 6 dhjetorit 2022, të Gjykatës së Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit) në lidhje me Aktgjykimin [C.nr.1536/18] e 18 shkurtit 2020, të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjyimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se parashtruesit të kërkesës i është shkelur e drejta e garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 20 [Vendimet] dhe 22 [Procedimi i kërkesës] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 25 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr.01/2023 (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).
5. Me 7 korrik 2023, Rregullorja e punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 01/2023, u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe hyri në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht, gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata Kushtetuese i referohet dispozitave të Rregullores së lartcekur. Lidhur me këtë, konform rregullit 78 (Dispozitat kalimtare) të Rregullores së punës Nr. 01/2023, përjashtimisht, dispozita të caktuara të Rregullores së punës Nr. 01/2018, do të vazhdojnë të zbatohen në lëndët e regjistruara në Gjykatë përpara shfuqizimit të saj, vetëm nëse dhe për aq sa janë më të favorshme për palët.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 3 mars 2023, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën e tij në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 7 mars 2023, Kryetarja e Gjykatës përmes Vendimit [Nr.GJR.KI57/23] caktoi gjyqtarin Radomir Laban Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Remzije Istrefi-Peci (kryesuese), Nexhmi Rexhepi dhe Enver Peci (anëtarë).
8. Më 14 mars 2023, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Në të njëjtën ditë, Gjykata ia dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës së Apelit.
9. Më 11 maj 2023, Gjykata kërkoi nga parashtruesi i kërkesës plotësimin e dokumentacionit, respektivisht dorëzimin e kopjeve të plota të aktgjykimeve në rastet e tjera.
10. Më 22 maj 2023, parashtruesi i kërkesës dorëzoi katër kopje të aktgjykimeve të Gjykatës së Apelit.
11. Më 30 gusht 2023, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Nga shkresat e lëndës rezulton se parashtruesi i kërkesës ishte i punësuar në Korporatën Energjetike të Kosovës sha.a (në tekstin e mëtejme: punëdhënësi) gjatë periudhës 17 maj 1976 deri më 20 janar 2017, kur marrëdhënia e punës i është ndërprerë për shkak të përmbushjes së moshës për pensionim, me të cilin rast, punëdhënësi ia kishte paguar 3 (tri) pagat përcjellëse.
13. Nga kartela e punëtorit rezulton se më 20 janar 2017, parashtruesi i kërkesës mbushi 44 vjet, 5 muaj e 5 ditë përvojë pune te punëdhënësi dhe kishte pagën bazë në vlerë prej 751,00 € (shtatëqind e pesëdhjetenjë euro).
14. Më 16 maj 2018, parashtruesi i kërkesës paraqiti padi kundër punëdhënësit, përmes të cilës, kërkoi nga i njëjti që atij t’ia paguajë, në emër të pagave jubilarë, shumën e përgjithshme prej 2,253.00 € (dy mijë e dyqind e pesëdhjetetë euro) me kamatë 8 % (tetë përqind) prej paraqitjes së padisë deri në pagesën definitive. Parashtruesi i kërkesës, kërkesëpadinë e tij e bazoi në nenin 52 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, e nënshkruar nga Partnerët në Këshillin Ekonomik Social (në tekstin e mëtejme: Marrëveshja e Përgjithshme) dhe nenin 90 (Marrëveshja Kolektive) të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës (në tekstin e mëtejme: Ligji i Punës).
15. Më 18 shkurt 2020, Gjykata Themelore, përmes Aktgjykimit [C.nr. 1536/18]: (i) aprovoi në tërësi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës; (ii) e detyroi ish-punëdhënësin që t’ia paguajë atij në emër të pagave jubilarë shumën prej 2,253.00 € (dy mijë e dyqind e pesëdhjetetë euro) me kamatë 8 % (tetë përqind) prej ditës së marrjes së aktgjykimit deri në pagesën definitive; dhe (ii) e detyroi ish-punëdhënësin t’i kompensojë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë të përgjithshme prej 270.00 € (dyqindeshtatëdhjetë euro), me arsyetimin si në vijim:

“Gjykata vlerëson se e paditura [punëdhënësi] ka pasur për detyrim që paditësit [parashtruesit të kërkesës] t’ia paguaj edhe tri paga në emër të shpërblimit jubilar për 30 vite të përvojës së punës. Kjo pasi që MPKK-ja [Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive] shprehimisht parasheh se punëdhënësi i fundit është ai i cili i paguan pagat jubilarë. Me rastin e pensionimit paditësi] i ka pasur më tepër se 40 vite përvojë pune. Pra, nga kartela e punëtorit, Gjykata vëren se paditësi është punësuar te e paditura me datë 08.07.1971. Rrjedhimisht, kjo nënkupton se paditësi i ka mbushur vitet e nevojshme të përvojës së punës për shpërblim jubilar. Ndërsa, e paditura ka qenë punëdhënësjja e fundit në momentin e pensionimit”.
16. Gjykata Themelore po ashtu konstatoi se parashtruesi i kërkesës ka parashtruar kërkesëpadinë më 16 maj 2018, gjegjësisht, brenda periudhës tre-vjeçare për parashtrimin e kërkesave monetare nga marrëdhënia e punës ashtu siç përcaktohet me nenin 87 (Afati i parashkrimit) të Ligjit të Punës.
17. Në një datë të paspecifikuar, ish-punëdhënësi parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit [C.nr. 1536/18] të 18 shkurtit 2020, të Gjykatës Themelore, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-006 të Procedurës Kontestimore (në tekstin e mëtejme: LPK), zbatimit të gabuar të drejtës materiale dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike..
18. Më 6 dhjetor 2022, Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit [AC. nr. 9423/2021] aprovoi si të bazuar ankesën e ish-punëdhënësit dhe e ndryshoi Aktgjykimin [C.nr. 1536/18] e 18 shkurtit 2020 të Gjykatës Themelore, si në vijim:

“I. REFUZOHET si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit Ismet Ferati, nga Vushtrria, [...], me te cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Korporata Energjetike e Kosovës sh.a, në Prishtinë, që paditësit, në emër të shpërblimit për tri paga jubilarë t’ia paguaj shumën prej 2,253.00 €, së bashku me normën e kamatës në lartësi prej 8 %, e cila do të llogaritet nga data e paraqitjes së padisë në gjykatë e deri në pagesën definitive.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.”

19. Gjykata e Apelit, ndër të tjera, arsyetoi se parashtruesi - kërkesën e tij për shpërblimin jubilar e ka mbështetur në Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive, e cila marrëveshje kishte hyrë në fuqi më 1 janar 2015 dhe në përputhje me paragrafin 4 të nenit 90 të Ligjit të Punës, kishte kohëzgjatje prej 3 (tri) viteve, gjegjësisht deri më 1 janar 2018, me të cilin rast i kishte pushuar efekti juridik. E njëjta vlerësoi se: *“[...] meqë nga kartela e punëtorit, e lëshuar për paditësin [parashtruesin e kërkesës] me nr. 2094, e dt. 20.01.2017, vërtetohet se i njëjti ka mbushur përvojë pune prej 44 vjet, 5 muaj e 5 ditë, nga kjo rezulton se paditësi kushtin për shpërblim jubilar për 30 vjet të përvojës së punës së pandërprerë e ka arritur para hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, gjegjësisht me dt. 15.08.2002. Nga kjo rezulton se kushti për shpërblim jubilar është përmbushur në një periudhë kohore në të cilën Marrëveshja e lartë cekur nuk ka qenë në fuqi dhe si e tillë nuk mund të prodhojë efekt juridik, gjegjësisht, të aplikohet në mënyrë retroaktive, e nga kjo rezulton se paditësit i mungon baza ligjore për realizimin e kërkesës së parashtruar në padi”.*
20. Për më tepër, Gjykata e Apelit konstatoi se edhe pse në rastin konkret, ish-punëdhënësi përmes vendimit të saj të 10 prillit 2019, kishte vendosur që t’i vazhdohet njohja e obligimit të pagesës së pagave jubilarë të gjithë punonjësve që i plotësojnë kushtet deri më 31 dhjetor 2019, pra që kanë arritur përvojën e punës *“[...] 10, 20, 30 duke përfshirë edhe ata punëmarrës të cilët e kanë arritur përvojën e punës 40 vite, prej 01.01.2015 dhe në vazhdimësi”*, parashtruesi i kërkesës 40 (dyzet) vjet përvojë pune i ka mbushur me 15 gusht 2012, pra, para hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive. Mbi këtë bazë, Gjykata e Apelit vendosi që të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar dhe kërkesëpadia e paditësit të refuzohet në tërësi si e pabazuar.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

21. Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta kanë shkelur të drejtën e tij të garantuar nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.
22. Parashtruesi i kërkesës ka bashkëngjitur 3 (tri) aktgjykime të Gjykatës së Apelit, respektivisht Aktgjykimin [Ac.nr.9423/21] të 6 dhjetorit 2022; Aktgjykimin [Ac.nr.1268/20] të 11 shkurtit 2019 dhe Aktgjykimin [Ac.nr. 538/19] të 6 majit 2019., për të cilat pretendon se janë të njëjta me rrethanat e rastit të tij. Megjithatë, Gjykata vë në dukje se parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij, nuk kishte dorëzuar kopjet e plota të tri aktgjykimeve të lartpërmendura. Si rezultat i kësaj, Gjykata rikujton se parashtruesit të kërkesës i kërkoi që të dorëzojë kopjet e plota të këtyre tri aktgjykimeve.
23. Parashtruesi i kërkesës në dokumentacionin shtesë të dorëzuar më 22 maj 2023, Gjykatës i dorëzoi kopjet e plota të 4 (katër) Aktgjykimeve të Gjykatës së Apelit si në vijim: Aktgjykimin [Ac.nr.4431/19, të 24 dhjetorit 2019; Aktgjykimin [Ac.nr. 4351/19, të 17 shtatorit 2019, Aktgjykimin [Ac.nr. 511/20], të 8 prillit 2021, dhe Aktgjykimin [Ac.nr. 1275/20] të 14 shtatorit 2020. Nga kjo rezulton, që kopjet e aktgjykimeve të

dorëzuara nga parashtruesi i kërkesës, më 22 maj 2023 nuk janë të njëjtat si ato të dorëzuara nga ai përmes kërkesës së tij, të 3 marsit 2023. Në lidhje me katër aktgjykimet e fundit, të dorëzuara nga ai më 22 maj 2023, parashtruesi i kërkesës thekson si në vijim: “Në bazë të kërkesës së Juaj Nr.ref.323-4/23, ua dërgojmë disa Aktgjykime t Gjykatës së Apelit në Prishtinë, që kanë vendosur në rastet e ngjashme në emër të kompensimit për rroga jubilarë” dhe se “Këto janë dëshmi të mjaftueshme për Gjykatën Kushtetuese, që me rastin e vendosjes për ushtruesit e kërkesave: [RR.A], [B.B], dhe [I.F], t’i aprovon kërkesat si të bazuara në mënyrë që ushtruesve të kërkesave të u sigurohet një gjykim i drejtë dhe i paanshëm”

24. Përderisa, përkitazi me shterimin e mjeteve juridike, parashtruesi i kërkesës thekson se: “Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit është i pa apelueshëm për faktin se është vlera e vogël dhe ndaj tij nuk mund të shtrohet revizioni”.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

- “1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.
3. Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të mediave, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj.
4. Çdokush i akuzuar për vepër penale ka të drejtë t’u bëjë pyetje dëshmitarëve dhe të kërkojë paraqitjen e detyrueshme të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe të personave të tjerë, të cilët mund të sqarojnë faktet.
5. Çdokush i akuzuar për vepër penale, prezumohet të jetë i pafajshëm derisa të mos dëshmohet fajësia e tij/saj, në pajtim me ligjin.”

KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Neni 6 (E drejta për një proces të rregullt)

“1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t’i ndalohe shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohe nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.
[...]

LIGJI Nr. 03/L-212 I PUNËS

**Neni 87
(Afati i parashkrimit)**

“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës.”

**Neni 90
(Marrëveshja Kolektive)**

[...]

4. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet.”

LIGJI Nr. 03/L-006 PËR PROCEDURËN KONTESTIMORE

**Neni 211
(pa titull)**

[...]

211.3 Revizioni nuk lejohet në kontestet pasurore-juridike në të cilat kërkesëpadia nuk ka të bëjë me kërkesat në para, me dorëzimin e sendit apo me përmbushjen e ndonjë premtimi tjetër, po që se vlera e objektit të kontestit e treguar në padinë e paditësit nuk e kalon shumën prej 3.000 Euro.[...]”

**MARRËVESHJA E PËRGJITHSHME KOLEKTIVE E KOSOVËS
(e nënshkruar nga partnerët në Këshillin Ekonomik Social më 18 mars
2014)**

**Neni 52
(Shpërblime jubilarë)**

“1. I punësuari, ka të drejtë në shpërblimin jubilar dhe atë:

1.1.për 10 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të një page mujore të tij;

1.2.për 20 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të dy paga mujore të tij;

1.3.për 30 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të tri paga mujore të tij.

2.Punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilarë.

3.Shpërblimi jubilar, paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf.”

**Neni 82
(pa titull)**

“1. Kjo Marrëveshje e Përgjithshme Kolektive e Kosovës (MPKK) e nënshkruar nga Partnerët në Këshillin Ekonomiko – Social të Kosovës, hyn në fuqi nga data 01.01.2015.

[...]”

**MENDIM JURIDIK PËR SHPËRBLIMIN JUBILAR I GJYKATËS SUPREME
TË KOSOVËS, i 27 shkurtit 2023**

Marrëveshja/Kontratat e aplikueshme

“II. Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës e lidhur me datë 18.03.2014, dhe nënshkruar nga Organizatat e punëdhënësve (Oda Ekonomike e Kosovës dhe Aleanca Kosovare e Biznesit), Organizatat e të punësuarve (Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës), si dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, (Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale), (në tekstin e mëtejme: Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës) aplikohet ne periudhën kohore nga data 01.1.2015 - 31.12.2017.”

Kushtet për të fituar të drejtën shpërblimit jubilar:

“VI. I punësuar ne bazë të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, ka të drejtë në shpërblimin jubilar siç përcaktohet me nenin 52, të kësaj marrëveshje, nëse plotësohen këto kushte dhe atë: a) që viti jubilar i punësimit për 10,20 dhe 30 vjet të arrihet në kohën kur kjo marrëveshje aplikohet si në pikën II, të këtij mendimi juridik, dhe b) përvoja e punës për 10, 20 dhe 30 vjet duhet të jetë e pandërprerë te punëdhënësi i fundit.”

**VENDIMI NR. 8261 I KORPORATËS ENERGJETIKE TË KOSOVËS SH. A., i
nxjerrë më 24 gusht 2019**

Vendim

“I. Vazhdohet njohja e obligimit për pagesën e pagave jubilarë për të gjithë punëmarrësit që kanë plotësuar kushtin deri më 31.12.2019, pra që kanë arritur përvojën e punës 10, 20 apo 30 vite, prej 01.01.2015 dhe në vazhdimësi.

[...]

III. Punëmarrësit të cilët kanë arritur përvojën e punës 40 vite gëzojnë këtë të drejtë njëjtë sikurse punëtorët që kanë arritur përvojën e punës 30 vite.”

Pranueshmëria e kërkesës

25. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

26. Në këtë drejtim, Gjykata u referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuar] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

27. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 47 [Kërkesa individuale], nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe nenit 49 [Afatet] të Ligjit të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të këtë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor.”

28. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në cilësinë e palës së autorizuar, dhe konteston Aktgjykimin [Ac.nr.9423/21], e 6 dhjetorit 2022, të Gjykatës së Apelit. Gjykata në vijim, vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka paraqitur revizion në Gjykatën Supreme për shkak se *“vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur të aktgjykimit nuk i kalon 3.000 Euro”* ashtu siç përcaktohet me paragrafin 2 të nenit 211 të LPK-së. Në këtë kuptim, marrë për bazë faktin që objekt i shqyrtimit të kërkesës është Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës së Apelit, i datës 6 dhjetor 2022, Gjykata do të vlerësojë nëse kërkesa e parashtruesit të kërkesës është dorëzuar brenda afatit të përcaktuar me Ligj dhe Rregullore të punës. Në lidhje me këtë të fundit, bazuar në faktin se parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesën e tij në Gjykatë më 3 mars 2023, ndërsa Aktgjykimi i gjykatës së Apelit është nxjerrë më 6 dhjetor 2022, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës ka paraqitur kërkesën e tij në Gjykatë brenda afatit të përcaktuar me ligj dhe Rregullore të punës, pasi që i ka shteruar mjetet juridike, si dhe ka saktësuar dispozitat kushtetuese për të cilat pretendon se janë cenuar në rastin e tij.
29. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 34 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores se punës. Paragrafi 2 i rregullit 34 të Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të së cilave Gjykata mund të shqyrtojë kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Specifikisht, pika d e paragrafit 1 dhe paragrafi 2 i rregullit 34 të Rregullores së punës përcaktojnë që:

“(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

[...]

(d) Kërkesa qartëson saktësisht dhe në mënyrë adekuate paraqet faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese.

[...]

(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi/ja nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij/saj”.

30. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkritazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”; dhe në fund, (iv) pretendime “konfuze dhe të paqarta”. Këtë koncept të papranueshmërisë mbi bazën e një kërkesë të vlerësuar si “qartazi të pabazuar”, dhe specifikat e katër kategorive të lartcekura të pretendimeve të kualifikuara si “qartazi të pabazuara” të zhvilluara përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata i ka përvetësuar edhe në praktikën e saj gjyqësore përfshirë por duke mos u kufizuar në rastet [KI40/20](#), parashtrues *Sadik Gashi*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 20 janarit 2021; [KI163/18](#), parashtrues *Kujtim Lleshi*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 24 qershorit 2020; [KI21/21](#), parashtrues, *Asllan Meka*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 28 prillit 2021, [KI107/21](#), parashtrues *Ramiz Hoti*, Aktvendim për Papranueshmëri, i 21 tetorit 2021).
31. Në këtë aspekt, dhe fillimisht, Gjykata rikujton që rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës ndaj ish-punëdhënësit të tij, për njohjen e të drejtës në shpërblim për 3 (tri) paga jubilarë bazuar në Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive. Gjykata Themelore kishte aprovuar padinë e parashtruesit të kërkesës si të bazuar. Si rezultat i ankesës së parashtruar nga ana e ish-punëdhënësit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjykatën e Apelit, kjo e fundit përmes Aktgjykimit të kontestuar [Ac.nr.9423/21], të 6 dhjetorit 2022, ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore dhe e refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës me arsyetimin se të njëjtit nuk i takon e drejta në shpërblim jubilar për shkak që 40 (dyzet) vjet përvojë pune i ka mbushur më 15 gusht 2012, gjegjësisht, para hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive.
32. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se përmes Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës së Apelit atij i është shkelur e drejta e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës. Gjykata vë në pah se parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij nuk ka specifikuar se si kjo e drejtë është shkelur në rastin e tij, mirëpo i njëjti përmes shkresës së tij, të dorëzuar më 22 maj 2023 ka bashkëngjitur 4 (katër) aktgjykime të Gjykatës së Apelit, për të cilat pretendon se: “Në bazë të kërkesës së *Juaj Nr.ref.323-4/23, ua dërgojmë disa Aktgjykime të Gjykatës së Apelit në Prishtinë, që kanë vendosur në rastet e ngjashme në emër të kompensimit për rroga jubilarë*” dhe se “*Këto janë dëshmi të mjaftueshme për Gjykatën Kushtetuese, që me rastin e vendosjes për ushtruesit e kërkesave: [Rr.A], [B.B], dhe [I.F], t’i aprovon kërkesat si të bazuara në mënyrë që ushtruesve të kërkesave të u sigurohet një gjykim i drejtë dhe i paanshëm*”
33. Në dritën e kësaj të fundit, Gjykata vëren se pretendimi i parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në substancë i referohet shkeljes së kësaj të drejte si rezultat i vendimeve kundërthënëse të gjykatave të rregullta.
34. Si rezultat i kësaj, Gjykata në vijim do t’i shtjellojë (i) parimet dhe kriteret e vendosura përmes praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ) përkritazi me mungesën e konsistencës të vendimeve gjyqësore (ii) duke i aplikuar të njëjtat në rrethanat e rastit konkret, në harmoni me të cilën praktikë, bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të

Kushtetutës, e njëjta është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.

(i) Parimet dhe kriteret e vendosura përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës përkitazi me mungesën e konsistencës të vendimeve gjyqësore

35. Lidhur me këtë, Gjykata fillimisht thekson se parimet dhe kriteret e vendosura nga GJEDNJ, kjo Gjykatë gjatë shqyrtimit të pretendimeve të parashtruesve për cenimin e parimit të sigurisë juridike, si rezultat i vendimeve kundërtënëse i ka zbatuar edhe në praktikën e saj tashmë të konsoliduar gjyqësore, të cilat ndër tjerash përfshijnë rastet [KI87/18](#), parashtrues “*IF Skadeforsikring*”, Aktgjykim i 27 shkurtit 2019 dhe [KI35/18](#), parashtrues *Bayerische Versicherungsverband*, Aktgjykim i 6 janarit 2019, [KI133/20](#), parashtrues *Raiffeisen Bank J.S.C.*, Aktgjykim i 30 marsit 2022; [KI78/21](#), parashtrues *Raiffeisen Bank J.S.C.*, Aktgjykim i 30 marsit 2022, ku Gjykata, ndër të tjera, kishte konstatuar shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së për shkak të cenimit të parimit të sigurisë juridike, si rezultat i divergjencës në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së.
36. Në dritën e zhvillimit të parimeve të përgjithshme përkitazi me vendimet kundërtënëse apo divergjencë në praktikën gjyqësore, Gjykata fillimisht i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, e cila ka theksuar vazhdimisht se një nga komponentët thelbësorë të sundimit të ligjit është siguria juridike, e cila, ndër të tjera, garanton një siguri të caktuar në situata juridike dhe kontribuon në besim publik në gjykata (shih, rastin e GJEDNJ-së [Brumărescu kundër Rumanisë \[DHM\]](#), kërkesa nr. 28342/95, paragrafi 61; rastin [Ştefănică dhe të tjerët kundër Rumanisë](#), nr. 38155/02, Aktgjykim i 2 nëntorit 2010, paragrafi 38, dhe rastin [Nejdet Şahin dhe Perihan Şahin kundër Turqisë](#), nr. 13279/05, Aktgjykim i 20 tetorit 2011, paragrafi 56, shih po ashtu rastin e Gjykatës, [KI28/23](#), parashtrues *Rrahim Haliti*, Aktvendim për Papranueshmëri i 29 qershorit 2023, paragrafi 61).
37. Sipas konstatimit të GJEDNJ-së, konstatim ky i afirmuar edhe përmes praktikës gjyqësore të vet Gjykatës është theksuar se: “prezenca e vendimeve kundërtënëse gjyqësore, në anën tjetër, mund të krijojë situata të pasigurisë juridike, e cila do ta ulte besimin e publikut në sistemin gjyqësor” (shih, rastin [Paduraru kundër Rumanisë](#), nr. 63252/00, paragrafi 98; [Vinčić dhe të tjerët kundër Serbisë](#), nr. 44698/06, Aktgjykim i 1 dhjetorit 2009, paragrafi 56; dhe rasti [Ştefănică dhe të tjerët kundër Rumanisë, të cituar më lart](#), paragrafi 38; shih në këtë aspekt rastet e Gjykatës, [KI133/20](#), parashtrues *Raiffeisen Bank J.S.C.*, i cituar më lart, paragrafi 118 dhe [KI78/21](#), parashtrues *Raiffeisen Bank J.S.C.*, i cituar më lart, paragrafi 89). GJEDNJ, megjithatë, ka specifikuar se nuk ka një të drejtë të fituar për konsistencë të praktikës gjyqësore. (shih, rastin [Unédic kundër Francës](#), nr. 20153/04, Aktgjykim i 18 dhjetorit 2008, paragrafi 74, shih rastin e cituar më lart [Nejdet Şahin dhe Perihan Şahin kundër Turqisë](#), paragrafi 56, shih po ashtu rastin e Gjykatës: [KI35/18](#), parashtrues *Bayerische Versicherungsverband*, cituar më lart paragrafi 65, [KI42/17](#), parashtrues *Kushtrim Ibraj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 25 janarit 2018, paragrafi 33, [KI133/20](#), parashtrues *Raiffeisen Bank J.S.C.*, i cituar më lart, paragrafi 117 dhe [KI78/21](#), parashtrues *Raiffeisen Bank J.S.C.*, i cituar më lart, paragrafi 87).
38. Në vijim, GJEDNJ ka vendosur tri kriteret themelore, të cilat janë pranuar edhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës për të përcaktuar nëse një divergjencë e vendimeve gjyqësore e pretenduar përbën shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së, dhe të cilat përcaktojnë si në vijim: (i) nëse ekzistojnë dallime “*të thella dhe afatgjata*” në praktikën gjyqësore; (ii) nëse ligji vendor përcakton mekanizma të aftë për të zgjidhur divergjencën të tilla;

dhe (iii) nëse ata mekanizma janë zbatuar dhe me çfarë efekti (në këtë kontekst, shih rastet e GJEDNJ-së, [Beian kundër Rumanisë \(nr.1\)](#), nr. 30658/05, Aktgjykim i 6 dhjetorit 2007, paragrafët 37-39; [Famullia Katolike Greke Lupeni dhe të tjerët kundër Rumanisë](#), nr. 76943/11, Aktgjykimi i 29 nëntorit 2016, paragrafët 116 - 135; [Jordan Iordanov dhe të tjerët kundër Bullgarisë](#), nr. 23530/02, Aktgjykim i 2 korrikut 2009, paragrafët 49-50; [Nejdet Şahin dhe Perihan Şahin kundër Turqisë](#), cituar më lart, paragrafi 53; dhe shih rastet e Gjykatës, [KI29/17](#), parashtrues [Adem Zhegrova](#), Aktvendim për papranueshmëri, i 5 shtatorit 2017, paragrafi 51; [KI42/17](#), parashtrues [Kushtrim Ibraj](#), cituar më lart, paragrafi 39; [KI87/17](#) parashtrues “*IF Skadiforsikring*”, cituar më lart, paragrafi 67; [KI35/18](#) parashtrues “*Bayerische Versicherungsverband*”, cituar më lart, paragrafi 70; [KI107/19](#), parashtrues [Gafurr Bytyqi](#), Aktvendim për papranueshmëri, i 11 marsit 2020, paragrafi 74; [KI133/20](#), parashtrues [Raiffeisen Bank J.S.C](#), cituar më lart, paragrafi 120; [KI78/21](#), parashtrues [Raiffeisen Bank J.S.C](#), cituar më lart, paragrafi 91; dhe [KI28/23](#), parashtrues [Rrahim Haliti](#), cituar më lart, paragrafi 63).

39. Gjykata vëren se sikurse GJEDNJ ashtu edhe vet Gjykata gjatë zhvillimit të konceptit të “*dallimeve të thella dhe afatgjata*” gjithashtu mori parasysh nëse mospërputhja është e izoluar apo afekton një numër të madh njerëzish (shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së, [Famullia Katolike Greke Lupeni dhe të tjerët kundër Rumanisë](#), cituar më lart, paragrafi 135, sai dhe rastet e Gjykatës [KI35/18](#), parashtrues [Bayerische Versicherungsverband](#), cituar më lart, paragrafi 72).
40. Gjykata, në këtë drejtim, gjithashtu thekson se GJEDNJ nuk ka konstatuar shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së në raste të praktikës divergjente gjyqësore edhe nëse e njëjta ka afektuar një numër të madh njerëzish në lidhje me të njëjtën çështje gjatë një periudhe të shkurtër kohore para se kundërthëniet përkatëse të zgjidheshin nga gjykatat më të larta, duke u dhënë mundësi kështu mekanizmave shtetërorë që të sigurojnë konsistencën e duhur (shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së, [Albu dhe të tjerët kundër Rumanisë](#), Aktgjykim i 10 majit 2012, paragrafët 42-43, dhe rastet e Gjykatës [KI35/18](#), parashtrues [Bayerische Versicherungsverband](#), cituar më lart, paragrafi 73, [KI133/20](#), parashtrues [Raiffeisen Bank J.S.C](#), të cituar më lart, paragrafi 122 dhe [KI78/21](#), parashtrues [Raiffeisen Bank J.S.C](#), të cituar më lart, paragrafi 92).
41. Kjo e fundit ndërlihet me kriterin e dytë dhe të tretë, përkatësisht me ekzistencën e një mekanizmi të aftë për të zgjidhur mospërputhjet në praktikën gjyqësore dhe nëse ky mekanizëm është përdorur dhe me çfarë efekti. Në këtë drejtim, GJEDNJ fillimisht ka konstatuar se mungesa e një mekanizmi të tillë përbën shkelje të së drejtës për një proces të rregullt gjyqësor të garantuar me nenin 6 të KEDNJ-së (shih, në këtë kontekst, [Tudor Tudor kundër Rumanisë](#), nr. 21911/03 , Aktgjykim i 4 marsit 2009, paragrafët 30-32; dhe [Ştefănică dhe të tjerët kundër Rumanisë](#), cituar më lart, paragrafët 37-38; dhe [Nejdet Şahin dhe Perihan Şahin kundër Turqisë](#), cituar më lart, paragrafi 54)., të cilin konstatim edhe Gjykata e ka afirmuar në praktikën e saj gjyqësore (shih rastet [KI35/18](#), parashtrues [Bayerische Versicherungsverband](#), cituar më lart, paragrafi 74, [KI133/20](#), parashtrues [Raiffeisen Bank J.S.C](#), të cituar më lart, paragrafi 123 dhe [KI78/21](#), parashtrues [Raiffeisen Bank J.S.C](#), të cituar më lart, paragrafi 93)

(ii) Zbatimi i parimeve dhe kriterëve të lartcekura në rrethanat e rastit konkret

42. Në vijim, Gjykata do të aplikojë parimet e elaboruara më lart në rrethanat e rastit konkret, duke aplikuar kriteret mbi bazën e të cilave Gjykata dhe GJEDNJ trajton çështjet e divergjencës përkitazi me praktikën gjyqësore, duke filluar me vlerësimin

nëse në rrethanat e rastit konkret, (i) divergjencat e pretenduara në praktikën gjyqësore janë “*të thella dhe afatgjata*”; dhe nëse ky është rasti, (ii) ekzistimin e mekanizmave të aftë për të zgjidhur divergjencën përkatëse; dhe (iii) vlerësimin nëse këta mekanizma janë zbatuar dhe me çfarë efekti në rrethanat e rastit konkret.

43. Fillimisht, Gjykata duhet gjithashtu të ritheksojë se, bazuar edhe në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe asaj të Gjykatës, nuk është funksioni i saj të krahasojë vendime të ndryshme të gjykatave të rregullta, edhe nëse merren në procedura dukshëm të ngjashme, pasi që pavarësia e tyre duhet të respektohet (shih rastin e GJEDNJ-së *Adamsons kundër Letonisë*, cituar më lart, paragrafi 118, shih po ashtu rastet e Gjykatës KI87/18 parashtrues *IF Skadeforsikring*, KI35/18, parashtrues *Bayerische Versicherungsverband*, KI133/20, parashtrues *Raiffeisen Bank J.S.C*, paragrafi 126, KI78/21, parashtrues *Raiffeisen Bank J.S.C*, paragrafi 96, të cituara më lart).
44. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës lidhur me pretendimet për shkelje kushtetuese të të drejtave dhe lirive themelore si rezultat i divergjencave në praktikën gjyqësore, duhet t’ia paraqes Gjykatës argumentet përkatëse përkitazi me ngjashmërinë faktike dhe juridike të rasteve të cilat pretendojnë se janë zgjidhur ndryshe nga gjykatat e rregullta, duke rezultuar në vendime kundërthënëse në praktikën gjyqësore dhe e cila mund të ketë rezultuar në shkelje të të drejtave dhe lirive të tyre kushtetuese të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së (shih rastin e cituar më lart KI35/18, parashtrues *Bayerische Versicherungsverband*, paragrafi 76).
45. Në këtë drejtim, Gjykata së pari rikujton pretendimin e parashtruesit të kërkesës, i cili, më 22 maj 2023 dorëzoi para saj 4 (katër) aktgjykime të Gjykatës së Apelit që kanë vendosur për rastet e ngjashme me rastin e tij në emër të kompensimit për paga jubilarë, dhe në lidhje me të cilat thekson se: “*Në bazë të kërkesës së Juaj Nr.ref.323-4/23, ua dërgojmë disa Aktgjykime t Gjykatës së Apelit në Prishtinë, që kanë vendosur në rastet e ngjashme në emër të kompensimit për rroga jubilarë*” dhe se “*Këto janë dëshmi të mjaftueshme për Gjykatën Kushtetuese, që me rastin e vendosjes për ushtruesit e kërkesave: [Rr.A], [B.B], dhe [I.F], t’i aprovon kërkesat si të bazuara në mënyrë që ushtruesve të kërkesave të u sigurohet një gjykim i drejtë dhe i paanshëm*”. Gjykata thekson se parashtruesi i kërkesës nuk ka dorëzuar parashtrësia të tjera lidhur me këto raste, për të cilat ka pretenduar lidhshmërinë faktike dhe juridike me atë të rastit të tij.
46. Gjykata rikujton se në rastet KI87/18, KI35/18, KI133/20 dhe KI78/21 të cituara më lart, ka konstatuar shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së për shkak të shkeljes së parimit të sigurisë juridike si rezultat i divergjencës së praktikës gjyqësore pasi kishte konstatuar se (i) kishte “*dallime të thella dhe afatgjata*”; (ii) mekanizmi i Gjykatës Supreme për harmonizimin e praktikës gjyqësore ekzistonte; porse (iii) mekanizmi i lartpërmendur nuk ishte përdorur.
47. Gjykata vëren se rrethanat e rasteve të lartcekura, [Ac.nr.4431/19]; [Ac.nr. 4351/19]; [Ac.nr. 511/20]; dhe [Ac.nr. 1275/20], të dorëzuara nga parashtruesi i kërkesës përmes shkresës së 22 majit 2023] ndërlidhen me atë se palë ndërgjyqëse në këto raste janë gjithashtu punëtorë tek i njëjti punëdhënës, respektivisht, Korporata Energjetike e Kosovës.
48. Megjithatë, duke iu referuar rasteve të referuara nga parashtruesi i kërkesës, Gjykata nga aktgjykimet e lartpërmendura vëren se në të 4 (katër) rastet e dorëzuara para saj, gjykata e shkallës së parë ka miratuar kërkesat e M.Sh., R.M., K.H., dhe M.A., për

pagesën e pagave jubilarë (Shënim i Gjykatës: vendimet e shkallës së parë për këto raste parashtruesi nuk i ka dorëzuar në Gjykatë). Tutje, pas ankesës që ish-punëdhënësi kishte parashtruar në Gjykatën e Apelit, ndër të tjera, duke pretenduar se në të 4 (katër) rastet ishte arritur afati i parashkrimit, kjo e fundit kishte refuzuar ankesën si të pabazuar. Më saktësisht, në **rastin e M.Sh.**, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ac. nr. 4431/2019] të 24 dhjetorit 2019, kishte konstatuar se në rastin konkret afati i parashkrimit nuk kishte kaluar sepse “[...] është paraqitur brenda afatit 3 vjeçar pas pensionimit të paditësit [parashtruesit të kërkesës]”; në **rastin e R. M.** të cilit Gjykata Themelore gjithashtu i kishte aprovuar padinë për pagesën e pagave jubilarë, dhe më pas, pas ankesës së ish-punëdhënësit, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ac.nr. 4351/19] të 17 shtatorit 2019 kishte refuzuar ankesën e ish-punëdhënësit, duke potencuar se në këtë rast padia është parashtruar në kohë, sepse “[...] padinë në Gjykatë e ka ushtruar me datë 09.03.2018 që nënkupton se padia është ushtruar brenda afatit ligjor të paraparë me nenin 87 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212[...];” në **rastin e K.H.**, Gjykata e Apelit po ashtu vërtetoi aktgjykimin e Gjykatës Themelore me të cilin të njëjtit i njihet e drejta në shpërblim të pagave jubilarë dhe përmes Aktgjykimit [Ac.nr. 511.20] të 8 prillit 2021, kishte konstatuar se “[...] padia është paraqitur brenda afatit ligjor të paraparë me dispozitat e nenit 87 të Ligjit të Punës [...]”; si dhe në **rastin e M.A.**, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ac.nr. 1275/20], të 14 shtatorit 2020, kishte vendosur se kërkesa e të njëjtit “[...] është e afatshme dhe nuk bëhet fjalë për parashkrim, ashtu siç është parapa në nenin 87 të Ligjit të Punës”, dhe më këtë pranoi arsyetimin e Gjykatës Themelore, me të cilin K.H-së, i njihet e drejta në paga jubilarë.

49. Ndërsa, në rastin e parashtruesit të kërkesës, Gjykata rikujton se Gjykata Themelore refuzoi padinë e parashtruesit me arsyetimin se parashtruesi gjatë periudhës sa kishte qenë në fuqi Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive nuk kishte përbushur kushtin e përvojës së punës 10, 20, 30 apo 40 vite punë, respektivisht, e njëjta vlerësoi se parashtruesi i kërkesës ka mbushur përvojë pune prej 30 (tridhjetë) vjet më 15 gusht 2002, gjegjësisht, para hyrjes në fuqi të marrëveshjes së lartcekur dhe si e tillë nuk mund të prodhojë efekt juridik, si dhe përkundër vendimit të ish-punëdhënësit të 10 prillit 2019, me të cilin kishte vendosur që t’i vazhdohet njohja e obligimit të pagesës së pagave jubilarë të gjithë punonjësve që i plotësojnë kushtet deri më 31 dhjetor 2019, sipas Gjykatës së Apelit, parashtruesi i kërkesës 40 (dyzet) vjet përvojë pune i ka mbushur me 15 gusht 2012, respektivisht, 3 (tri) vjet para hyrjes në fuqi të MPKK-së, andaj, nuk i takon e drejta në shpërblim jubilar.
50. Gjykata po ashtu vëren se vendimmarrja e Gjykatës së Apelit dhe asaj të shkallës së parë, në rrethanat faktike dhe juridike të rastit konkret është në pajtueshmëri edhe me Mendimin Juridik për Shpërblimin Jubilar të nxjerrë nga mbledhja e përgjithshme e Gjykatës Supreme, e 27 shkurtit 2023, në të cilën përcaktohet se: “I punësuari në bazë të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, ka të drejtë në shpërblimin jubilar siç përcaktohet me nenin 52, të kësaj marrëveshje, nëse plotësohen këto kushte dhe atë: a) që viti jubilar i punësimit për 10, 20 dhe 30 vjet të arrihet në kohën kur kjo marrëveshje aplikohet si në pikën II, të këtij mendimi juridik, dhe b) përvoja e punës për 10, 20 dhe 30 vjet duhet të jetë e pandërprerë te punëdhënësi i fundit”.
51. Duke rikujtuar detyrimin e përcaktuar përmes praktikës gjyqësore të Gjykatës që parashtruesit e kërkesës duhet t’i paraqesin Gjykatës argumentet përkatëse përkitazi me ngjashmërinë faktike dhe juridike të rasteve të cilat pretendojnë se janë zgjidhur ndryshe nga gjykatat e rregullta, duke rezultuar në vendime kundërtë në praktikën gjyqësore, Gjykata vëren se përveç dorëzimit të 4 (katër) vendimeve të Gjykatës së Apelit, ku parashtruesi pretendon rrethanat faktike dhe juridike të ngjashme si ato në rastin e parashtruesit, parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur që

Gjykatës ta paraqesë argumente shtesë, apo raste tjera që janë vendosur ndryshe nga Gjykata e Apelit, dhe rrjedhimisht ta mbështesë pretendimin e tij për cenim të sigurisë juridike, si rezultat i vendimeve kundërthënëse të gjykatave të rregullta.

52. Për më tepër, në rastin konkret, Gjykata vëren se Gjykata e Apelit ka konstatuar se parashtruesit të kërkesës nuk i takon drejta në shpërblim jubilar për shkak se i njëjti nuk ka përmbushur vitet e përvojës gjatë periudhës kohore që Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive ka qenë në fuqi. Në anën tjetër, në 4 (katër) rastet e tjera, kopjet e të cilave parashtruesi i kërkesës kishte dorëzuar në Gjykatë më 22 maj 2023, gjykatat e rregullta kanë arsyetuar që paditësve respektiv nuk i është parashkruar drejta për shpërblim jubilar si dhe që iu takon kjo drejtë sepse kanë përmbushur kushtin e përvojës së punës.
53. Në dritën e praktikës së vet gjyqësore, Gjykata vlerëson se nuk është e mundur të konstatohet ekzistimi i *"dallimeve të thella dhe të vazhdueshme"* në praktikën gjyqësore të Gjykatës së Apelit që rrezikojnë parimin e sigurisë juridike, duke u thirrur në 4 (katër) aktgjykime të Gjykatës së Apelit, rrethanat e të cilave dallojnë me rastin e parashtruesit të kërkesës.
54. Andaj, Gjykata konsideron se as numri i aktgjykimeve të paraqitura si kundërthënëse, si dhe as mënyra se si Gjykata e Apelit ka vlerësuar dhe trajtuar rastin e parashtruesit të kërkesës nuk krijojnë bazë të mjaftueshme për të arsyetuar pretendimin për shkelje të parimit të sigurisë, si rrjedhojë e vendimeve kundërthënëse të gjykatave të rregullta (shih rastet e Gjykatës KI29/17, parashtrues *Adem Zhegrova* të cituar më lart, paragrafi 58 dhe KO28/23, parashtrues *Rrahim Haliti*, të cituar më lart, paragrafi 82).
55. Rrjedhimisht, Gjykata konkludon se kërkesa, në tërësinë e saj, është e papranueshme si qartazi e pabazuar në baza kushtetuese në *"mungesë evidente të shkeljes"* ashtu siç është përcaktuar me rregullin 34 (2) të Rregullores së Punës;

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe në pajtim me rregullat 34 (2), si dhe 48 (1) (b) të Rregullores së punës, më 30 gusht 2023, njëzëri:

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 të Ligjit; dhe
- IV. TË KONSTATOJË që ky vendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtar raportues

Radomir Laban



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Gresa Caka-Nimani